

## Termet e Referencës

Ekspert/e për hartimin e Strategjisë së Marrëdhënieve me Publikun dhe Komunikimit si dhe trajnimin e stafit të HANDIKOS-it

### I. HYRJE

HANDIKOS, “Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës” është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden personat me aftësi të kufizuara në Kosovë, e themeluar nga dhe për personat me aftësi të kufizuara, me aktivitete të pandërprera që nga viti 1983. Si organizatë përfaqëson, përkrahë dhe punon për dhe me personat me aftësi të kufizuara përmes avokimit dhe lobimit. Ofron shërbime të ndryshme përmes rrjetit të shtrirë në gjithë Kosovën dhe promovon barabarësinë, jetën e pavarur dhe me dinjitet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

### II. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

HANDIKOS në partneritet me Save the Children në Kosovë është duke implementuar projektin “Handikos for Child Rights-H4CR”, i cili financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (SIDA). Përmes këtij projekti HANDIKOS synon ngritjen e kapaciteteve dhe fuqizimin e fëmijëve me Aftësi të Kufizuara.

### III. OBJEKTIVA E DETYRËS

HANDIKOS kërkon të angazhojë një ekspert/e për të hartuar një Strategji të Marrëdhënieve me Publikun dhe Komunikimit, e cila do të jetë në përputhje me misionin e organizatës dhe objektivat e saj të avokimit, si dhe për të ofruar trajnime praktike për stafin në fushën e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun. Kjo strategji do të ndihmojë në përmirësimin e dukshmërisë institucionale, fuqizimin e avokimit dhe komunikimin efektiv me përfituesit, partnerët dhe publikun e gjerë.

Përmes kësaj detyre synohet:

- Të zhvillohet një strategji gjithëpërfshirëse e PR dhe komunikimit që përcakton mesazhet kyçe, mjetet, kanalet dhe qasjet për komunikim të brendshëm dhe të jashtëm;
- Të identifikohen format më efikase për të rritur praninë e HANDIKOS-it në media dhe rrjete sociale;
- Të mbështetet organizata në zhvillimin e mekanizmave për menaxhimin e imazhit publik dhe krizave komunikative;
- Të aftësohet stafi i HANDIKOS-it përmes trajnimeve praktike në komunikim publik, përgatitje për media, ndërtim mesazhesh dhe përdorim strategjik të platformave komunikative.

#### IV. KUALIFIKIMI

- Diplomë universitare në shkenca të komunikimit, marrëdhënie me publikun, gazetari, marketing, menaxhim ose fusha të ngjashme;
- Përvojë e dëshmuar në hartimin e strategjive të PR dhe komunikimit institucional, sidomos në sektorin joqeveritar;
- Njohuri për çështjet e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe përfshirjen sociale;
- Aftësi të shkëlqyera në analizë, dokumentim dhe përgatitje të materialeve komunikative;
- Eksperiencë në lehtësimin e trajnimeve për komunikim dhe marrëdhënie me publikun;
- Aftësi të mira komunikuese dhe bashkëpunuese me ekiye të ndryshme profesionale.

#### V. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Eksperti/ja do të jetë përgjegjës/e për:

- Analizimin e gjendjes aktuale të komunikimit institucional të HANDIKOS-it;
- Hartimin e Strategjisë së PR dhe Komunikimit që përfshin: objektivat, mesazhet kyçe, audiencat, kanalet, planin e veprimit dhe indikatorët e matjes;
- Hartimin e një udhëzuesi të shkurtër për përdorimin praktik të strategjisë nga stafi;
- Hartimin dhe zbatimin e trajnimeve për stafin mbi:
  - Marrëdhëniet me publikun;
  - Komunikimin e organizatës në situata të ndryshme;
  - Prezantimin në media dhe ndërtimin e mesazheve avokuese;
  - Përdorimin strategjik të rrjeteve sociale dhe mjeteve digjitale të komunikimit
- Dorëzimin e materialeve të trajnimit dhe raportit përmbledhës të punës së realizuar.

#### VI. ANGAZHIMI I ESKPERTIT/ES

Eksperti/ja do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me HANDIKOS. Angazhimi do të bëhet gjatë muajit Gusht 2025 në bazë ditore, ku do të përfshihen aktivitetet e mëposhtme:

| Detyra                                                      | Kohëzgjatja |
|-------------------------------------------------------------|-------------|
| Përgatitja për organizimin e trajnimit me stafin e HANDIKOS | 1 ditë      |
| Fasilitimi i trajnimit me stafin e HANDIKOS                 | 2 ditë      |
| Hartimi i strategjisë së PR dhe Komunikimit                 | 4 ditë      |
| TOTALI                                                      | 7 ditë      |

## VII. KUSHTET E PAGESËS

Pagesa e ekspertit/es do të bëhet sipas faturës përkatëse për kryerjen e shërbimeve, që do të leshohet nga ai/ajo. Pagesa do të bëhet pas përfundimit të trajnimit dhe dorëzimit të dokumentit final të aprovuar nga HANDIKOS.

HANDIKOS do të realizoj pagesën në Euro, shuma bruto për ditët e punës (nga të cilat do të ndalet tatimi në fitim dhe kontributi pensional sipas ligjeve në fuqi në Kosovë).

HANDIKOS rezervon të drejtën e negociimit të propozimit financiar.

## VIII. PROCEDURA PËR APLIKIM

- Metodologjia e punës për këtë angazhim (max. 3 faqe);
- Curriculum Vitae (CV) (max.3 faqe);
- Propozimi financiar

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: [handikos@handi-kos.org](mailto:handikos@handi-kos.org) cc: [nora.simitciu@handi-kos.org](mailto:nora.simitciu@handi-kos.org) dhe [antika.maksutaj@handi-kos.org](mailto:antika.maksutaj@handi-kos.org)

Ju lutem, shkruani në subjekt Aplikimi për “Ekspert/e për hartimin e Strategjisë së Marrëdhënieve me Publikun”

**Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është 17 Shtator, ora 17:00.**

**Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen!**

Pas përzgjedhjes Eksperti/ja i përzgjedhur duhet të dërgojë:

- **Dokumentin/ Dëshminë që nuk jeni nën hetime.**
- Poashtu duhet të nënshkruaj **Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve** si dhe **Rregulloren mbi Parandalimin e Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual — PSHAS** dhe t'u përmbahen kushteve dhe kriterëve të tyre.